

MBROJTJA E HAPËSIRËS SË SHOQËRISË CIVILE NË BE

Organizatet e shoqërisë civile përballen me një sërë sfidash në të gjithë Bashkimin Evropian. Raporti i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) *Mbrojtja e hapësirës së shoqërisë civile në BE* paraqet gjetjet e agjencisë lidhur me këto sfida. Ai u publikua në shtator të vitit 2021. Kjo përmbledhje paraqet gjetjet kryesore dhe opinionet e FRA-së, të cilat përshkruhen në raport.

GJETJET KRYESORE DHE OPINIONET E AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

2

Nxitja e një mjedisi mundësues dhe mbështetja e zhvillimit të shoqërisë civile

3

Promovimi i një mjedisi rregullator të favorshëm

5

Qasja dhe përdorimi i fondeve

6

Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile

7

Garantimi i një hapësire të sigurt, pa ngacmime dhe sulme



© Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2022

Riprodhimi autorizohet vetëm nëse citohet burimi.

Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive apo materialeve të tjera, për të cilat Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore nuk ka të drejta autori, duhet të merret leje drejtpërdrejt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

As Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, as ndonjë individ që vepron në emër të agjencisë nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2022

Print ISBN 978-92-9461-696-8 doi:10.2811/254371 TK-01-21-424-SQ-C

PDF ISBN 978-92-9461-692-0 doi:10.2811/387870 TK-01-21-424-SQ-N

© Autorësia e fotografive:

Kopertina (nga lart poshtë): © Jose Jordan/BELGA/AFP, Day Of Victory Stu./Adobe Stock, babaroga/Adobe Stock

Faqe 3: © Valmedia/Adobe Stock

Faqe 5: © Supertrooper/Adobe Stock

Faqe 8: © fizkes/Adobe Stock

Gjetjet kryesore dhe opinionet FRA-së

Organizatat ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, të tilla si Këshilli i të Drejtave të Njeriut i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, organe të tjera të Këshillit të Evropës, si dhe Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR) e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) e vënë theksin te roli i rëndësishëm i shoqërisë civile për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Në Bashkimin Evropian, shoqëria civile luan rol të rëndësishëm për t'i dhënë jetë vlerave të përbashkëta të BE-së dhe Shteteve Anëtare, të cilat specifikohen në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Shoqëria civile jep një kontribut thelbësor në zbatimin e politikave të BE-së në fushën e të drejtave të njeriut. Roli kryesor i shoqërisë civile pasqyrohet edhe në Traktatet e BE-së. Po kështu, dokumentet politike, strategjitë dhe planet përkatëse të veprimit të BE-së, theksojnë rëndësinë e saj.

Neni 11, paragrafi 2, i TBE-së dhe neni 15, paragrafi 1, i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) i konsiderojnë dialogun civil dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile si mjete të qeverisjes së mirë. Kjo gjë parashtrohet edhe në dokumentet e rëndësishme të politikave të BE-së, të tilla si strategjia e BE-së për të përforcuar zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ("Karta e BE-së"), Plani i Veprimit për Demokracinë Evropiane, si dhe planet sektoriale kundër racizmit, për barazinë e personave pjesë e LGBTQI+, për integrimin e romëve, për të drejtat e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, të viktimave, grave ose për integrimin e imigrantëve.

E megjithatë, organizatat e shoqërisë civile përballen me një sërë sfidash në të gjithë Bashkimin Evropian. Ky raport paraqet gjetjet e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) për disa nga këto sfida. Gjetjet mbështeten te kërkimet e bëra nga rrjeti i agjencisë për hulumtimet, Franet, në vitin 2020; dy konsultime të veçanta në internet së bashku me organizatat e shoqërisë civile në vitin 2020 dhe një hulumtim i mbështetur në dokumentacion.

FRA-ja ka nxjerrë vazhdimisht në pah një numër të madh pengesash për OSHC-të qëkur nxori raportin e saj në vitin 2018 për ***Sfidat me të cilat përballen shoqëritë civile që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në BE***. Kjo agjenci ka identifikuar edhe zhvillime pozitive të cilat stimulojnë një mjedis mundësues për këto organizata.

Normat dhe praktikat që kanë ndikim te shoqëria civile zakonisht njihen me emrin "hapësira të shoqërisë civile". Sipas ***Shënimit udhëzues të OKB-së për mbrojtjen dhe nxitjen e hapësirave të shoqërisë civile***, "hapësira e shoqërisë civile është mjedisi që iu mundëson njerëzve dhe grupeve, ose aktorëve të hapësirës së shoqërisë civile, të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote në jetën politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të shoqërive të tyre". Ky shënim më tej vë në dukje se "[a] në mënyrë që hapësira e shoqërisë civile të gjallërojë, ka nevojë për mjedis të hapur, të sigurt dhe pa rrezik, pa akte frikësuese, ngacmuese dhe hakmarrëse, qofshin këto të ardhura nga interneti ose jo. Çdo kufizim i kësaj hapësire duhet të jetë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

Kjo hapësirë përfshin kuadrin rregullator përkatës, qasjen te burimet, pjesëmarrjen në politikëbërje e në vendimmarrje dhe një mjedis të sigurt. Këto norma dhe praktika mund të kenë ndikime pozitive ose negative në zbatimin e legjislacionit dhe politikave të BE-së, madje edhe në zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Raporti i FRA-së për *Mbrojtjen e hapësirës së shoqërisë civile në BE* nënvizon zhvillimet e rëndësishme në fushën e legjislacionit dhe të politikave, të cilat kanë ndikim te veprimtaritë e OShC-ve që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në BE. Ky raport paraqet edhe praktikën premtuese. Përveç kësaj, opinionet e paraqitura më poshtë ravijëzojnë mënyrat për nxitjen e një mjedisi pune më pozitiv për shoqërinë civile.

Në përgjithësi, kërkimet nënvizojnë se situata ndryshon shumë midis Shteteve Anëtare. Ato tregojnë gjithashtu se situata në vitin 2020 ishte përgjithësisht më e vështirë se vitet e tjera, shpeshherë për shkak të pandemisë së Covid-19. Pavarësisht këtij realiteti, kërkimet nxjerrin në pah edhe disa zhvillime pozitive.

Nxitja e një mjedisi mundësues dhe mbështetja e zhvillimit të shoqërisë civile

Në vitin 2020, rreth një e treta (33 %) e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në të gjithë BE-në, të cilat iu përgjigjën konsultimeve të FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile, thanë se kushtet për OShC-të që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në vendin e tyre ishin “të mira” ose “shumë të mira”. Sidoqoftë, një e treta (31 %) tha se kushtet ishin “të këqija” ose “shumë të këqija”. Për më tepër, më shumë se gjysma e organizatave kombëtare ose vendore të anketuara (57 %) thanë se, në vitin 2020, situata “u përkeqësua” ose u “përkeqësua shumë”, krahasuar me vitet e mëparshme.

Hapat pozitive të ndërmarra në disa shtete anëtare të BE-së përfshijnë masat politike për një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile dhe për përmirësimin e bashkëpunimit midis autoriteteve publike dhe OShC-ve. Këtu përfshihet krijimi i infrastrukturës që synon mundësimin e hapësirës për dialog, kanalizimin e mbështetjes ndaj shoqërisë civile dhe angazhimet specifike për qeverisjen e hapur, edhe në kuadrin e planeve kombëtare të veprimit për **Partneritetin e Qeverisjes së Hapur**.

Në disa shtete anëtare të BE-së, OShC-të janë tejet aktive në përpjekjet për të përmirësuar kuadrin e politikave brenda të cilit ato veprojnë, edhe nëpërmjet krijimit të koalicioneve. Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (IKDNJ), në cilësinë e tyre si mbrojtëse të të drejtave të njeriut, janë të angazhuara për të mbështetur hapësirën e shoqërisë civile. Ato janë të angazhuara edhe për të promovuar, mbrojtur dhe mbështetur të gjithë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në **Planin Rajonal të Veprimit të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut** për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, i cili bazohet në **Deklaratën e Marrakeshit**.

Këshilli i Evropës në **Rekomandimin CM/Rec(2018)11 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me nevojën për të forcuar mbrojtjen dhe përkrahjen e hapësirës së shoqërisë civile në Evropë** ripohon se mbrojtja dhe përkrahja e hapësirës së shoqërisë civile kërkon që Shtetet Anëtare të garantojnë “një mjedis të favorshëm politik dhe publik” për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe OShC-të. Ky mjedis bën të mundur që OShC-të dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut të kryejnë lirisht punën e tyre.

Promovimi i shoqërive civile dinamike e të fuqishme është po ashtu pjesë e politikës globale të BE-së për të drejtat e njeriut. Në vitin 2021, Këshilli i Bashkimit

Evropian përtëriu mbështetjen e tij për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe OShC-të dhe u angazhua për të zgjeruar mbështetjen e tij për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile. **Udhëzimet e BE-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut** japin sugjerime praktike për të përmirësimin e masave të BE-së në mbështetje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Komisioni Evropian, ka mbështetur edhe zhvillimin e **“Metrit të OShC-ve”** për të vlerësuar mjedisin e shoqërisë civile në vendet e Partneritetit Lindor, në kuadrin e Instrumentit Evropian të Fqinjësisë. Përveç kësaj, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, në *Udhëzimet për mbështetjen e BE-së në favor të shoqërisë civile në vendet candidate për anëtarësim*, të cilat u zhvilluan në konsultim me shoqërinë civile, me synimin për të përkrahur një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile, partneritetin dhe dialogun midis shoqërisë civile dhe institucioneve publike, si dhe fleksibilitetin dhe kapacitetet e OShC-ve.

Promovimi i një mjedisi rregullator të favorshëm

Mjedisi i favorshëm rregullator kërkon një kuadër të fortë legjislativ, i cili mbron dhe promovon të drejtat e lirisë për organizim, për tubim paqësor dhe të shprehjes, në përputhje me të drejtat dhe standardet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Ky aspekt u nënvizua së fundmi në **shënimin udhëzues të OKB-së për mbrojtjen dhe promovimin e hapësirës së shoqërisë civile**, i cili u botua në shtator të vitit 2020.

Këto të drejta janë të sanksionuara edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila është e detyrueshme për shtetet anëtare në zbatim të së drejtës së BE-së, por edhe në rastet kur legjislacioni ose praktikat kombëtare kanë lidhje me legjislacionin e BE-së dhe për rrjedhojë hyjnë në fushëzbatimin e tij, edhe pse miratohen në mënyrë autonome.



OPINIONI 1 I FRA-SË

Në kuadër të veprimtarisë së tyre për të përforcuar zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe shtetin e së drejtës, institucionet e BE-së duhet të monitorojnë hapësirën e shoqërisë civile në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë ngushtësisht në të edhe aktorët e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut. Për këtë qëllim, mund të përshtatet metodologjia e Komisionit Evropian për **“Metrin e OShC-ve”**, e cila zbatohet në vendet e Partneritetit Lindor. Ky mekanizëm duhet të zhvillohet në konsultim të ngushtë me shoqërinë civile dhe duhet të identifikojë rrugët me të cilat institucionet e BE-së mund të reagojnë me shpejtësi, kur ekzistojnë prova për kufizime të hapësirës së shoqërisë civile. Rezultatet e monitorimit mund të përfshihen në raportet vjetore të Komisionit Evropian për Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe në kuadër të raportimit për shtetin e së drejtës, së bashku me rekomandimet dhe orientimet strategjike për përmirësimin e situatës.

BE-ja dhe shtetet anëtare të tij inkurajohen të përdorin Rekomandimin CM/Rec(2018)¹¹ e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, lidhur me nevojën e fuqizimit të mbrojtjes dhe promovimit të hapësirës së shoqërisë civile në Evropë dhe shënimin udhëzues të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për mbrojtjen dhe promovimin e hapësirës së shoqërisë civile, të cilët tregojnë hapat dhe proceset për të mbrojtur dhe përkrahur hapësirën e shoqërisë civile. Pavarësisht faktit se zbatohen në politikat e jashtme të BE-së, udhëzimet e BE -së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, mund të shërbejnë edhe si frymëzim.

Në pajtim me Rekomandimin CM/Rec(2021)¹¹ e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për zhvillimin dhe fuqizimin e institucioneve kombëtare efektive, pluraliste dhe të pavarura të të drejtave të njeriut, shtetet anëtare duhet të garantojnë se IKDNj-të e tyre kanë burime të mjaftueshme për t'u angazhuar plotësisht me aktorët e shoqërisë civile për të drejtat e njeriut dhe të monitorojnë sfidat nga të cilat preken këta aktorë.

OPINIONI 2 I FRA-SË

Në kuadër të veprimtarisë së tyre për të përforcuar zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe të shtetit të së drejtës, institucionet dhe Shtetet Anëtare të BE-së – kur vepron brenda fushëzbatimit të së drejtës së BE-së – duhet të garantojnë se BE-ja dhe legjislacionet e vendeve anëtare fuqizojnë të drejtat e lirisë së shprehjes, të tubimit paqësor dhe të organizimit. Për më tepër, ato duhet të garantojnë se transpozimi dhe zbatimi i normave të BE-së nuk do të shkaktojë kufizime joproporcionale lidhur me veprimtarinë e shoqërisë civile.

Komisioni Evropian duhet të garantojë konsultimin me shoqërinë civile gjatë përgatitjes ose shqyrtimit të legjislacionit që mund të prekë hapësirën dhe liritë civile. Komisioni Evropian mund të marrë në konsideratë dhënien e udhëzimeve të detajuara për zbatimin e normave të tij, duke u mbështetur te praktikat e mira ekzistuese, për të parandaluar kufizimet e padëshiruara.

Shtetet Anëtare duhet të garantojnë se ligjet që mund të kufizojnë hapësirën e veprimit të shoqërisë civile përputhen me legjislacionin e BE-së dhe me parimet dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, si p.sh., me Deklaratën e OKB-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Ata duhet të konsultohen me një sërë organizatash të shoqërisë civile gjatë hartimit dhe zbatimit të legjislacionit që mund t'i prekë këto organizata.

Institucionet e BE-së mund të shfrytëzojnë vlerën e shtuar të harmonizimit të rregullave bazë për funksionimin e OSHC-ve në tregun e brendshëm të BE-së.

Deklarata e OKB-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, edhe pse nuk është instrument detyrues, përmban parime dhe të drejta që mbështeten te standardet e të drejtave të njeriut, të cilat janë të sanksionuara në instrumente të tjera ndërkombëtare detyruese.

Organizatave pjesëmarrëse në konsultimin e FRA -së me shoqërinë civile në vitin 2020, raportuan vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre themelore: rreth një e treta (29 %) hasnin vështirësi në ushtrimin e së drejtës për tubim paqësor, një e katërta (25 %) në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe thuajse një në pesë (18 %) në ushtrimin e lirisë së organizimit. Vështirësitë që këto organizata raportojnë, lidheshin më së shumti me masat e marra në kuadrin e pandemisë Covid-19, për shembull ligjet për emergjencat, kufizimet e udhëzimit, ndalimi i vizave si dhe kufizimet e lirisë së tubimit dhe organizimit.

Sfidat e tjera lidheshin me mjedisin ligjor, për shembull: me legjislacionin për dialogun civil dhe konsultimet (25 %); me ligjet për transparencën ose lobimin (20 %); me ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale (18 %); me ndryshimet në ligjet për statusin e organizatave bamirëse (14 %); me masat kundër pastrimit të parasë (12 %); me ndryshimet në legjislacionin tatimor (11 %); me legjislacionin ose politikën kundër terrorizmit (11 %) dhe me dispozitat ligjore për fushatat politike (10 %).

Masat që prekin lirinë për tubim paqësor, si ndalimi i rreptë të tubimeve, mbikëqyrja e tubimeve, e organizatorëve dhe pjesëmarrësve në këto tubime, sanksionet dhe përdorimi i forcës për ruajtjen e rendit gjatë manifestimeve, të lidhura kryesisht me masat në kuadrin e pandemisë Covid-19, por jo vetëm me to. Thuajse gjysma e të anketuarve gjatë konsultimeve të FRA-së për Covid-19, i konsideruan kufizimet e lidhura me Covid-19 si në shpërpjesëtim. Krahas kësaj, dëshmitë e mbledhura nga Franet, rrjeti i hulumtimeve të FRA-së, tregojnë se, në disa shtete, ligjet e miratuara rishtazi për tubimet nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pandeminë Covid-19 dhe nuk përfshijnë ndonjë proces real konsultimi, për të mos thënë asnjë.

Sa i takon lirisë së shprehjes, aktorët e shoqërisë civile në një sërë shtetesh anëtare konstatuan se dispozitat që kriminalizonin fjalën e lirë, duke përfshirë këtu ato që shihen si të nevojshme për të luftuar terrorizmin, mund të kenë efekt shkurajues në ushtrimin e lirisë së shprehjes. Në disa shtete anëtare, përpjekjet për të trajtuar problematikat e gjuhës së urrejtjes, sidomos në internet, kanë ngritur shqetësime për ndikim potencial joproporcional mbi fjalën e lirë.

Dëshmitë e mbledhura nga FRA-ja tregojnë se disa qeveri kanë bërë përpjekje për të lehtësuar të drejtën e lirisë së organizimit. Këto përpjekje përfshijnë lehtësimin e barrës së burokracisë, përmirësimin e kuadrit për mbrojtjen e të dhënave si dhe thjeshtëzimin dhe modernizimin e sistemeve të regjistrimit.

Megjithatë, në një pjesë të Shteteve Anëtare, si raportet e Franet ashtu edhe burimet e shoqërisë civile identifikojnë sfida të vazhdueshme serioze, si ligjet ose barra administrative për

shpërbërjen dhe çregjistrimin e OShC-ve, ose rregulla jo të favorshme për statusin e tyre. Rregullat më të rrepta për krijimin dhe funksionimin e OShC-ve, të propozuara në disa shtete anëtare për të mbrojtur sigurinë kombëtare ose vlerat demokratike, kanë nxitur kritika për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e tyre. Përveç kësaj, pasojat e padëshiruara anësore të rregullave në kuadrin e luftës kundër pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit duket se vazhdojnë të dëmtojnë veprimtarinë e OShC-ve.

Qasja dhe përdorimi i fondeve

Gjetja dhe qasja e burimeve dhe fondeve mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për OShC-të. Këtë shqetësim e rëndoi pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020. Në total, 60 % e të anketuarve gjatë konsultimit të FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile në vitin 2020, raportojnë se kanë pasur vështirësi në gjetjen e fondeve, pavarësisht përpjekjeve për përmirësimin e kuadrit të financimeve në disa Shtete Anëtare. Edhe nëse ka fonde të disponueshme, OShC-të hasin pengesa për marrjen e tyre.

Ndër sfidat e raportuara gjatë konsultimit për hapësirën e shoqërisë civile renditen: konkurrenca me OShC-të e tjera për fonde të kufizuara (49 %), kapacitetet e kufizuara administrative për të aplikuar për fonde (35 %), mungesa e transparencës dhe drejtësisë në shpërndarjen e fondeve (30 %) dhe kriteret kufizuese të pranimit për fonde (29 %). OShC-të raportuan edhe një sërë problematikash të lidhura me pandeminë, të tilla si transferimi i fondeve publike në aspekte të tjera me përparësi, reduktimi i donacioneve private, pamundësia për të organizuar aktivitete për mbledhje fondesh dhe reduktimi i kontributeve në natyrë, për shembull e punës vullnetare.

Në disa Shtete Anëtare, aktorët e shoqërisë civile raportojnë praktika financimi diskriminuese ose kufizuese të cilat dëmtojnë, në mënyrë të veçantë, OShC-të që punojnë në fushën e barazisë gjinore, në fushën e të drejtave të personave lesbikë, gej, biseksualë, transgjjinorë dhe ndërgjjinorë (LGBTI) si dhe të OShC-ve që punojnë me komunitetet e imigrantëve dhe pakicat fetare; këto praktika mund të cenojnë zbatimin e strategjive të miratuara nga BE-ja në këto fusha.

Në përgjithësi, duket se organizatat advokuese janë prekur më shumë se OShC-të që ofrojnë shërbime. Përveç kësaj, OShC-të në të paktën tetë shtetet anëtare kanë shprehur shqetësim për ligjet që vendosin kufizime të reja ndaj donacioneve të huaja dhe rregulla më të rrepta për OShC-të që përfitojnë fonde të huaja; për njërin prej shteteve, këto ligje u bënë objekt i një vendimi të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.



OPINIONI 3 I FRA-SË

Gjatë shqyrtimit të programeve për disbursimin e fondeve të BE-së me menaxhim të përbashkët, duke përfshirë Fondet Strukturore dhe Investimet Evropiane (ESIF) dhe planin e rimëkëmbjes "NextGenerationEU", Komisioni Evropian duhet të marrë në konsideratë nevojat për financim të shoqërisë civile. Komisioni duhet të kontrollojë mënyrën si disbursohen fondet pranë OShC-ve dhe t'u japë Shteteve Anëtare udhëzime dhe trajnim për përfshirjen e OShC-ve në mënyrë më efektive.

Sipas "Rregullores për Dispozitat e Përbashkëta" për menaxhimin e përbashkët të fondeve të BE-së, Shtetet Anëtare duhet të mbështeten te ekspertiza e shoqërisë civile kur monitorojnë kushtet mundësuese që lidhen me të drejtat themelore, madje edhe te kushtet mundësuese horizontale që lidhen me Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së dhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe – sipas rastit – te kushtet mundësuese tematike që lidhen me barazinë gjinore, integrimin e romëve etj.

Komisioni Evropian duhet të vazhdojë të respektojë normat kombëtare që rregullojnë qasjen dhe përdorimin e fondeve nga OShC-të në prizmin e dispozitave përkatëse të BE-së dhe të vendimeve më të fundit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, duke përfshirë lëvizjen e lirë të kapitalit brenda BE-së, dhe t'u ofrojë Shteteve Anëtare, përmes përfshirjes së OShC-ve, një hapësirë për shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të mira në këtë fushë.

Institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare duhet të garantojnë që mjedisi ligjor dhe i politikave të jetë i favorshëm, në mënyrë që OShC-të të mund të kenë qasje në grupe të ndryshme burimesh dhe që ato të mos hasin pengesa të panevojshme kur u qasen fondeve nga burime vendase ose të huaja, qoftë edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjive. Mbështetja financiare duhet të mbulojë gamën e plotë të veprimtarive të shoqërisë civile, duke përfshirë këtu advokimin, angazhimin e komunitetit dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Krahas financimit të projekteve, sektori i shoqërisë civile do të fuqizohet nga financimet bazë të infrastrukturës dhe ciklet shumëvjeçare të financimit. Këto do të siguronin edhe qëndrueshmërinë e punës së shoqërisë civile për të drejtat e njeriut.

Disa zhvillime pozitive janë identifikuar po ashtu. Disa shtete anëtare të BE-së kanë përmirësuar kuadrot e tyre të përgjithshme të financimit, ndërsa të tjerët kanë përcaktuar një kuadër tatimor më të favorshëm për OShC-të. Një pjesë e shteteve anëtare kanë krijuar skema mbështetjeje specifike për OShC-të, në mënyrë që ato të luftojnë pasojat e pandemisë së Covid-19. OShC-të kanë mirëpritur programin e ri **EU Citizens, Equality, Rights and Values** (Qytetarët e BE-së, Barazia, Të drejtat dhe Vlerat), i cili ka rritur buxhetin për periudhën 2021–2027 në mënyrë të konsiderueshme krahasuar me periudhat e mëparshme të financimit. "**Norway Grants' Active Citizens Fund**" (Fondi për Qytetarët Aktivë, i granteve norvegjeze), i administruar nëpërmjet operatorëve të pavarur të fondeve, ofron mbështetje thelbësore për OShC-të në 13 Shtete Anëtare.

Udhëzimet e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut dhe udhëzimet e Komisionit të Venecias për lirinë e organizimit vërejnë se, "aftësia për të kërkuar, siguruar dhe përdorur burime është thelbësore për ekzistencën dhe funksionimin e çdo shoqate". Qasja dhe përdorimi i fondeve iu jep shoqatave mjetet për të funksionuar dhe ndjekur misionin e tyre, prandaj financimet janë element i pandashëm i së drejtës për lirinë e organizimit.

Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile

Sipas kërtimeve të FRA-së dhe raporteve të shoqërisë civile, pavarësisht përpjekjeve në disa shtete anëtare për të përmirësuar konsultimin me shoqërinë civile, kanalet për qasjen dhe pjesëmarrjen e OShC-ve në vendimmarrje mbeten përgjithësisht fragmentare dhe shpesh nuk mbështeten siç duhet me qasje në informacionet e duhura ose me standarde apo udhëzime të qarta.

Konsultimet e FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile kanë treguar vazhdimisht se OShC-të janë të shqetësuara për qasjen dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes. Konsultimet e FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile në vitin 2020 treguan se këto shqetësime i referohen veçanërisht: mungesës së informacionit të përshtatshëm për proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit (46 %), mungesës së besimit ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve publike (35 %), mungesës së reagimit për atë që ka ndodhur me kontributet e dhëna dhe pengesat e ndryshme, ku përfshihen ato me natyrë diskriminuese, në qasjen dhe pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes (24 %).

Përdorimi i gjerë i procedurave legjislative të shpejta dhe emergjente në pjesën më të madhe

të shteteve anëtare gjatë pandemisë, i përkeqësoi edhe më shumë problemet ekzistuese. OShC-të pretendojnë gjithashtu se pakicat dhe grupet e cenushme shpeshherë nuk përfaqësohen denjësisht gjatë konsultimeve.

Kërkimet e FRA-së kanë identifikuar disa përpjekje për të përmirësuar proceset e konsultimit, për shembull hapja e proceseve të mbyllura për konsultim dhe njëfarë progresi në krijimin e një infrastrukture për të lehtësuar bashkëpunimin e OShC-ve me autoritetet kombëtare dhe pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e politikave dhe strategjive. Masat e BE-së mund të shërbejnë si katalizator në këtë drejtim, pasi mjaft strategji të BE-së kërkojnë miratimin e planeve kombëtare të veprimit. Për këtë arsye, përfshirja e OShC-ve konsiderohet praktikë e mirë.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes dhe të vendimmarrjes është tregues i demokracisë dhe kontribuon për cilësinë dhe efektshmërinë e ligjeve dhe politikave. Neni 11 i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) e përkufizon dialogun civil si përbërës thelbësor të demokracisë pjesëmarrëse dhe kërkon që institucionet e BE-së "t'u japin qytetarëve dhe shoqatave përfaqësuese mundësinë për të bërë të ditura dhe për të shkëmbyer publikisht mendimet e tyre në të gjitha fushat e veprimit të BE-së" dhe "të mbajnë dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me shoqatat përfaqësuese dhe shoqërinë civile". Konferenca për të ardhmen e Evropës dhe Plani i veprimit për demokracinë e BE-së kanë potencialin të shtojnë rrugët për të rritur pjesëmarrjen në BE.

Garantimi i një hapësire të sigurt, pa ngacmime dhe sulme

E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut iu garanton njerëzve të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personit, pjesëmarrjen në çështjet publike dhe që të mos kenë asnjë ndërhyrje të panevojshme në ushtrimin e lirisë së shprehjes, tubimit dhe organizimit. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë angazhuar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat janë të rëndësishme për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, dëshmitë e marra nga FRA-ja dhe nga organizatat e tjera tregojnë se kërcënimet dhe sulmet kundrejt OShC-ve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut si dhe kundër gazetarëve, blogerëve dhe sinjalizuesve ende vazhdojnë në BE. Këtu hyjnë kërcënimet dhe ngacmimet e shpeshta nga interneti ose jo (40 % e të anketuarve gjatë konsultimit të FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile në vitin 2020 raportuan sulme nga interneti dhe 26 % raportuan sulme jashtë tij), si dhe shkatërrim të mjediseve dhe pronës (8 %) dhe sulme fizike (4 % e të anketuarve). Për më tepër, shkalla e moskallëzimit të tyre është e lartë (më pak se një në tre i kallëzon këto sulme) dhe OShC-të shprehin zhgënjimin për mënyrën si trajtohen këto incidente nga autoritetet.



OPINIONI 4 I FRA-SË

Me synimin për të zbatuar nenin 11 të TBE-së, BE-ja mund të marrë në konsideratë krijimin e një kuadri politikash të BE-së, që do të bëjë të mundur dialogun e hapur, transparent dhe të rregullt midis institucioneve të BE-së dhe shoqërisë civile në BE dhe në rang kombëtar e vendor. Ky kuadër duhet të përfshijë mjetet e duhura që i mundësojnë qytetarëve dhe shoqatave përfaqësuese të bëjnë të ditura dhe të shkëmbejnë publikisht mendimet e tyre në të gjitha fushat ku vepron BE-ja.

Në këto mjete mund të përfshihen fondet për proceset e përshtatshme, trajnimi i funksionarëve dhe organizimi i rregullt i konsultimeve dhe i shkëmbimeve të shoqërisë civile edhe përmes përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe të Parlamentit Evropian në shtetet anëtare. Ky kuadër duhet të lehtësojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në konsultimet për legjislacionin dhe politikën e BE-së, përgjatë gjithë ciklit të politikave. Në këtë aspekt, theksi duhet vënë te qasja e informacionit dhe pjesëmarrja e OShC-ve që përfaqësojnë grupet e cenushme dhe ato të nënpërfaqësuar.

Për zhvillimin e këtij kuadri, Këshilli i Evropës jep udhëzime në Udhëzimet për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në vendimmarrje. Kur ndjekin zbatimin e planeve më të fundit të veprimit, të strategjive dhe të kornizave të tjera politike të BE-së në fushën e të drejtave themelore, sidomos sa i takon zbatimit të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe në fushat e luftës kundër racizmit, të barazisë së personave LGBTQ+, integritit të romëve, të të drejtave të fëmijëve, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të drejtave të viktimave, të barazisë gjinore dhe integritit të imigrantëve, shtetet anëtare duhet të nxiten që të integrojnë rezultatet e këtyre konsultimeve si dhe rezultatet e ardhshme të Konferencës për të ardhmen e Evropës dhe të Planit të veprimit për demokracinë e BE-së.

FRA OPINION 5

Gjatë monitorimit dhe vlerësimit të normave dhe instrumenteve të BE-së në mbrojtje të të drejtave të viktimave të krimit dhe gjatë rishikimit të dispozitave të BE-së për luftën ndaj gjuhës dhe krimit të urrejtjes, në raportin e hartuar për Vendimin Kuadër për luftën kundër disa formave dhe shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë, Komisioni Evropian duhet të përmendë sulmet ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Komisioni Evropian duhet të garantojë që nisma e tij e ardhshme kundër SLAPP-eve të ofrojë mbrojtje efektive nga ngacmimet ligjore ndaj OShC-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Kjo mbrojtje duhet të përfshijë garanci të njëtrajtshme procedurale kundër padive abuzive, dispozita që përjashtojnë "libel tourism", "forum shopping" dhe detyrimin për t'u ofruar ndihmë dhe mbështetje viktimave të SLAPP-eve. Komisioni Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet të përdorin mjetet përkatëse për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve dhe profesionistëve të sistemit gjyqësor për ndikimin negativ të praktikave të SLAPP-eve.

Duke u mbështetur te shembulli i mekanizmit të jashtëm ekzistues të BE-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut protectdefenders.eu, BE-ja duhet të marrë në konsideratë dhënie e mbështetjes së përshtatshme financiare për krijimin dhe mirëmbajtjen e një mekanizmi të ngjashëm monitorimi në BE, duke u bërë të mundur OShC-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut të raportojnë sulmet, të regjistrojnë situatat e alarmit, të klasifikojnë prirjet dhe t'u japin viktimave mbështetje të shpejtë dhe të specifikuar.

Shtetet anëtare duhet të garantojnë që krimet e kryera kundër OShC-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut të regjistrohen, hetohen dhe përndiqen siç duhet, duke shfrytëzuar dispozitat për krimet me bazë urrejtjen, sipas rastit. Politikanët dhe politikëbërësit mund të kontribuojnë për zhvillimin e një narrative pozitive për shoqërinë civile dhe të theksojnë rolin e saj të rëndësishëm, duke shmangur deklaratat që mund të ushqejnë armiqësinë kundrejt OShC-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe që mund të kenë efekt shkurajues në punën e shoqërisë civile në fushën e të drejtave të njeriut.

Shtetet anëtare duhet mos kriminalizojnë ose të marrin masa ligjore të ngjashme me kriminalizimin, të cilat vështirësojnë veprimtarinë e OShC-ve në kontekstin e ndihmës humanitare për azilkërkuesit dhe imigrantët e tjerë gjatë kërkim-shpëtimit në det.

Në disa shtete anëtare, OShC-të ankohen për klimë armiqësore kundrejt tyre dhe kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut; më shumë se një e treta e OShC-ve raportuan fushata shpifjesh nga mediat ose aktorët shtetërorë. Në krahasim me këtë, në shtete të tjera anëtare, qeveritë, politikanët dhe zyrtarët e nivelit të lartë kanë nënvizuar rolin jetësor të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të aktorëve të tjerë të shoqërisë civile në përkrahjen e të drejtave dhe në garantimin e llogaridhënies, sidomos gjatë pandemisë së Covid-19.

Ndër organizatat dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, veçanërisht të prekura janë ato që punojnë me grupet e pakicave, me refugjatët dhe imigrantët e tjerë, organizatat kundër racizmit dhe ato që punojnë në fushën e të drejtave të grave, të drejtave seksuale dhe të shëndetit riprodhues dhe të drejtave të komunitetit LGBTI. Mungesa e një mjedisi të sigurt, në mënyrë që OShC-të të përmbushin funksionet e tyre ka ndikim potencial te zbatimi i strategjive përkatëse të BE-së. Në të njëjtën kohë, provat tregojnë kriminalizim të vazhdueshëm të veprimtarisë së shoqërisë civile dhe masave ligjore kundër tyre, sidomos në rastin e misioneve të kërkim-shpëtimit në det dhe të ndihmës humanitare për personat në nevojë gjatë transferimit.

Janë vënë re edhe pengesa ligjore dhe administrative, sidomos përmes përndjekjeve abuzive dhe padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Komisioni Evropian ka njoftuar në Planin e tij të veprimit për demokracinë në BE se ka porositur një studim gjithëpërfshirës për mënyrën si ndikohen OShC-të dhe aktorët e shoqërisë civile në të gjithë BE-në nga SLAPP-et dhe mbi këtë bazë do të propozojë një nismë për t'i luftuar ato..



Puna e FRA-së për hapësirën e shoqërisë civile

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ka përgjegjësinë që t'u japë institucioneve, organeve, zyra dhe agjencive përgjegjëse të BE-së dhe të shteteve anëtare (kur vepron brenda fushëzbatimit të legjislativitetit të BE së) asistencë dhe ekspertizë në fushën e të drejtave themelore, përmes instrumenteve të ndryshme.

Në këtë kontekst, FRA-ja ka detyrën të bashkëpunojë me një sërë palësh të interesuara, me organizata joqeveritare dhe institucione të shoqërisë civile të cilat janë aktive në fushën e të drejtave themelore,^a përmes Platformës së saj për të Drejtat Themelore. Nëpërmjet kësaj platforme,^b OShC-të japin kontribut dhe reagime të dobishme për punën e agjencisë, për zhvillimin e kushteve e hapësirës mundësuese, ku OShC-të të mund të punojnë e dhe për kuadrin ligjor dhe politik të BE-së në fushën e të drejtave themelore.

Duke u bazuar në kërkimet të Franet^c, raporti i FRA-së në vitin 2018 për **Sfidat me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile në punën me të drejtat e njeriut në BE** identifikoi një numër vështirësish me të cilat përballen shoqëria civile – për shembull, aspektet e punës rregullore të qeverisë, disponueshmëria e fondeve, mundësitë për të kontribuar në ligjërbërje dhe politikëbërje si dhe ngacmimet dhe ligjëratat negative të cilat sabotojnë punën e shoqërisë civile.

Në vitin 2020, agjencia i kërkoi përsëri rrjetit të saj të hulumtimeve, Franet, t'i jepte informacion për zhvillimet ligjore dhe politike që lidhen me hapësirat mundësuese për shoqërinë civile në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si dhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi, si vende candidate për anëtarësim. Informacioni mbulonte vitin 2020.

Përveç kësaj, që prej vitit 2018, agjencia është konsultuar çdo vit me aktorët e shoqërisë civile që marrin pjesë në Platformën e saj për të Drejtat Themelore. Në total, konsultimit në internet për hapësirën e shoqërisë civile në vitin 2020 iu përgjigjën 398 OShC, që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut nga 27 Shtetet Anëtare të BE-së, duke përfshirë 50 organizata përfaqësuese në rang BE-je.^d Këto organizata janë aktive në nivel ndërkombëtar, evropian, kombëtar ose vendor dhe punojnë në një sërë fushash veprimtarie ku përfshihet advokimi, fushatat dhe ndërgjegjësimi, dhënia e shërbimeve, angazhimi i komunitetit, mbështetja për viktimat, kërkimi dhe mbledhja e të dhënave dhe proceset gjyqësore.

Për të mbledhur përgjigje më specifike për ndikimin e Covid-19, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ndërmori një tjetër konsultim në internet, i cili mbulonte periudhën mars-nëntor 2020.^e Në total, anketimit iu përgjigjën 177 OShC nga e gjithë BE-ja; 35 prej tyre ishin organizata përfaqësuese që ishin aktive në të gjithë BE-në.

Përveç kësaj, FRA-ja organizoi disa mbledhje me ekspertë dhe shkëmbime me OShC-të që janë aktive në fushën e të drejtave të njeriut. Konkretisht, mbajti në internet takimin vjetor të Platformës për të Drejtat Themelore "Puna për të drejtat e njeriut në kohë të vështira: rrugët për të ecur përpara" në shkurt të vitit 2021. Kjo mbledhje, e cila bëri bashkë mbi 300 OShC nga e gjithë BE-ka, dha informacion shtesë për vështirësitë dhe mundësitë që aktorët e shoqërisë civile përjetojnë dhe hasin në punën e tyre.^f

^a *Shih Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 168/2007, të datës 15 shkurt 2007, për krijimin e Agjencisë për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian, Gazeta Zyrtare nr. L 53, vitit 2007 (Rregullorja themeluese).*

^b *Për më shumë informacion rreth Platformës për të Drejtat Themelore të FRA-së, shih faqen përkatëse.*

^c *Franet është rrjeti shumëdisiplinor i agjencisë për hulumtime. Ky rrjet përbëhet nga subjekte të kontraktuara në çdo Shtet Anëtar, në Mbretërinë e Bashkuar dhe në vendet që kanë statusin e vëzhguesit të cilat, sipas kërkesës, i japin FRA-së të dhëna të rëndësishme për problematikat e të drejtave të njeriut, për të lehtësuar analizat krahasuese të agjencisë.*

^d *Shih pyetësorin "Konsultimi i FRA-së në vitin 2020 për përvojat e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me të drejtat e njeriut në BE".*

^e *Shih FRA (2021), 'Covid-impact on civil society work – Results of consultation with FRA's Fundamental Rights Platform', 24 shkurt 2021.*

^f *FRA (2021), Human rights work in challenging times: Ways forward – Report of the meeting of FRA's Fundamental Rights Platform 2021.*



PROMOVOJMË DHE MBROJMË TË DREJTAT TUAJA THEMELORE NË TË GJITHË BASHKIMIN EVROPIAN

Për raportin e plotë, shih:
<https://fra.europa.eu/en/publication/2021/civic-space-challenges>

INFORMACIONE TË MËTEJSHME



FRA – AGJENCIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE
Schwarzenbergplatz 11 - 1040 Vjenë - Austri
T +43 158030-0 - F +43 158030-699
fra.europa.eu

 facebook.com/fundamentalrights
 linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency
 twitter.com/EURightsAgency



Publications Office
of the European Union